



Tiranë më 03.10.2019

E nderuar Autoriteti i Mediave Audiovizive (sa vijon edhe vetëm "AMA"),

Ju drejtohem me këtë ankesë që ka karakter **urgjent**, për sa më poshtë vijon.

Në mbështetje të Ligjit nr. 97/2013 "Per Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) dhe vendimeve te miratuar nga institucioni juaj për mbylljen e transmetimeve analoge dhe kalimin në transmetim digital po ju parashtrojmë ankesën për sa më poshtë vijon:

Sipas Vendimit të miratuar së fundmi nga ana e Institucionit tuaj me nr. 119, datë 30.09.2019 për "Mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës, në datën 01 tetor 2019" (publikuar në faqen web të AMA-s, dhe që i bashkëlidhur kësaj ankesë), nga ana jonë si OSHMA është proceduar me mbylljen e transmetimit analog dhe fillimin e transmetimit digital në respekt të këtij vendimi dhe Ligjit "Per Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Konstatohet me shqetësim, ashtu edhe si ju jeni në dijeni nga mbikqyrja e OSHMA – ve në treg, se operatorë te tjere si Klan, Klan Plus, ABC News, Shjiak Tv etj. nuk e kanë respektuar këtë vendim dhe vazhdojnë të transmetojnë pervec ne digitale edhe në sinjal analog në qarqet Tiranë dhe Durrës. Ky transmetim po bëhet në kundërshtim me vendimin tuaj dhe, për më tepër, ka krijuar pabarazi dhe deformim të konkurencës në treg.

Sjellim në vëmendjen tuaj që shkelje të tillë sanksionohen nga nenet 18, 19, 78, 88, 132, 133 të Ligjit nr. 97/2013 "Per Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe, sipas të drejtave dhe rëndësisë së zgjatjes së kësaj situate, mund të jenë objekt i mosmarrëveshjeve që do të lindin dhe shqyrtohen nga organet gjyqësore kompetente për shpërbilitet e dëmeve të shkaktuara.

Nisur nga sa më lart kërkojmë nga strukturat e AMA-s që të ndërmarrin masat e duhura operacionale dhe ligjore, për të detyruar këta operatore të zbatojne ligjin dhe të mos prishin ekuilibrat e tregut kaq sensibël si ai i mediave, duke mos u bërë palë me shkaktuesit e shkeljeve më sipër cituar.

Në prite të reagimit tuaj urojmë në zgjidhjen sa më shpejt të kësaj situate.

News 24



Vizioni +

Report Tv



Ora HD



Top Channel



Ora News

